

Njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga Shoqëria për ndërtimtari, tregti dhe shërbime BEST VEJ INVESTMENT SHPKNJP, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ORKA HOLDING SHA Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut mbi Shoqërinë për ndërtimtari, tregti dhe shërbime SOFIJA GRADBA SHPK Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut (lënda nr. 08-60 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24 dhe 16/25), më datë 10.03.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar një njoftim për përqendrim me të cilin Shoqëria për ndërtimtari, tregti dhe shërbime BEST VEJ INVESTMENT SHPKNJP Shkup me seli të regjistruar në rr. Slavejko Arsov nr.138-1, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ORKA HOLDING SHA Shkup, Republika me seli të regjistruar në rr. Skupi nr.3A Shkup marrin kontrollin e përbashkët mbi Shoqërinë për ndërtimtari, tregti dhe shërbime SOFIJA GRADBA SHPK Shkup me seli në rr. Orce Nikolov nr. 71/1 Shkup, përmes shitblerjes së pjesëve.

-Shoqëria për ndërtimtari, tregti dhe shërbime BEST VEJ INVESTMENT SHPKNJP Shkup, rr. Slavejko Arsov nr.138-1, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut. Shoqëria është e regjistruar për veprimtarinë e tregtisë me pakicë të karburanteve motorike dhe lubrifikantëve në dyqane të specializuara. Shoqëria përmes një personi të lidhur mbi të cilin ka 100% pronësi kryen tregti me shumicë të karburanteve të ngurta, të lëngshme dhe të gazta në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe atë:

-Shoqëria për tregti dhe shërbime OMPETROL OIL SHPKNJP Petrovec me seli në rr.4 nr.100, Rzhaniçino Petrovec, Republika e Maqedonisë së Veriut e cila është e regjistruar për veprimtarinë Tregti me shumicë e karburanteve të ngurta, të lëngshme dhe të gazta dhe produkteve të ngjashme, përkatësisht kryen tregti me shumicë të naftës dhe derivateve të naftës në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas licencës nga Komisioni Rregullator i Energjetikës.

-Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ORKA HOLDING SHA Shkup me seli në rr. Skupi nr.3A Shkup. Shoqëria aksionare është me veprimtari të regjistruar - Veprimtari menaxhuese. Shoqëria është pronare/bashkëpronare e personave juridikë të mëposhtëm:

- 100% pronësi mbi Shoqërinë ndërtimore tregtare BETON SHTIP SHPKNJP Shtip, me seli në rr. Goce Dellçev nr. 117 Shtip, me veprimtari të regjistruar – Ndërtimi i ndërtesave banesore dhe jo-banesore;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për ndërtimtari, tregti dhe shërbime DELTA 2015 KONSTRAKSHN SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, veprimtari e regjistruar Ndërtimi i ndërtesave banesore dhe jo-banesore;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime KARA SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me veprimtari të regjistruar: Lëshimi dhe administrimi i patundshmërive vetanake ose patundshmërive të marra me qira (leasing); (lizing);
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime MONT SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me veprimtari të regjistruar Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme;

- 100% pronësi mbi IPSH – Qendra e dializës NEFROPLUS Kavadarçë, me seli në rr. Shishka nr. 1 Kavadarçë, me veprimtari të regjistruar Veprimtari e praktikës mjekësore specialitike;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për ndërtimtari, tregti dhe shërbime O.K. HOTEL SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me veprimtari të regjistruar Hotele dhe objekte të ngjashme për akomodim;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për reklamë, marketing, tregti dhe shërbime O.K. IDEA SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me veprimtari të regjistruar Agjenci marketingu;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për tregti dhe shërbime OK MEDIA SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me veprimtari të regjistruar Reklamim përmes mediave;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për hotelieri, tregti dhe shërbime O RESTAURANTS & BARS SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Aminta i Tretë nr. 29 Shkup, me veprimtari të regjistruar Restorante dhe objekte të tjera për përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit;
- 100% pronësi mbi Agjencinë për sigurimin e pronave dhe personave OK SECURITY SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me veprimtari të regjistruar Veprimtari të mbrojtjes private;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për transport, tregti dhe shërbime OK TRANSPORT SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me veprimtari të regjistruar Transport rrugor i mallrave;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për hotelieri dhe turizëm ORKA HOTEL SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Orce Nikolov nr. 55 Shkup dhe veprimtari të regjistruar Hotele dhe objekte të ngjashme për akomodim;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për hotelieri dhe shërbime PANORAMA RESIDENCE SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup dhe veprimtari të regjistruar Ndërtimi i ndërtesave banesore dhe jo-banesore;
- 100% pronësi mbi Fondacionin Ilija Kamçev Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup dhe veprimtari të regjistruar Veprimtari të organizatave të tjera me bazë anëtarësimi, të përmendura diku tjetër;
- 47% pronësi mbi IPSH në pronësi të përzier Spitali Klinik ACIBADEM SISTINA Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 5A Shkup dhe veprimtari të regjistruar Veprimtari spitalore

-Shoqëria për ndërtimtari, tregti dhe shërbime SOFIJA GRADBA SHPK Shkup me seli në rr. Orce Nikolov nr. 71/1 Shkup. Shoqëria është e regjistruar me veprimtarinë e ndërtimit të ndërtesave banesore dhe jo-banesore.

Shoqëria për ndërtimtari, tregti dhe shërbime BEST VEJ INVESTMENT SHPKNJP Shkup dhe Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ORKA HOLDING SHA Shkup zotërojnë nga 50% të pjesëve në Shoqërinë për ndërtimtari, tregti dhe shërbime SOFIJA GRADBA SHPK Shkup me seli në rr. Orce Nikolov nr. 71/1 Shkup, dhe me këtë kanë kontroll të përbashkët mbi këtë shoqëri.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni ka përcaktuar se përqendrimi në fjalë mund të bëjë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

17.03.2025

Shkup